



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:077936

Datë: 22.07.2019

Numri i dokumentit: 00426836

C.nr.721/2018

GJYKATA KOMUNALE NË GJAKOVË, si gjykatë civile e shkallës së parë, në përbërje nga gjyqtari Besnik Bislimaj, me zyrtaren ligjore Merita Xharavina në kontestin e paditësit A.Sh., Komuna Gjakovë, të cilin e përfaqëson me autorizim B.M., avokat nga Gjakova, kundër të paditurës P.O.S., L.L.C., Fushë Kosovë, të cilën e përfaqëson me autorizim avokat E.K. nga Prishtina me objekt të padisë anulimin e aktvendimit për ndërprerjen e kontratës së punës dhe kompensimin e të ardhurave personale, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me dt. 22.07.2019 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESRISHT APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.Sh., Komuna Gjakovë ashtu që **ANULOHET si i paligjshëm** aktvendimi i të paditurës Nr. 02/2016 i datës 06.04.2016, me të cilin paditëses i është ndërprerë kontrata e punës e datës 31.07.2015.

II. DETYROHET e paditura P.O.S., L.L.C., Fushë Kosovë, që në emër të kompensimit të të ardhurave personale, ti paguajë paditësit 3 (tri) paga mujore.... në shumë prej 750.00 euro së bashku me kamatën prej 195,10 euro për periudhën kohore prej 06.04.2016 deri më 30.06.2016, me kamat prej 8% duke filluar nga dita e përpilimit të këtij aktgjykimi, me datë 22.07.2019, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. DETYROHET e paditura P.O.S., L.L.C., Fushë Kosovë që paditësit t'ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej 609.60 euro €, në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

IV. PJESA TJETËR E KËRKESË padisë së paditësit A.Sh., Komuna Gjakovë, me të cilën ka kërkuar që “ të detyrohet e paditura P.O.S., L.L.C., Fushë Kosovë, që paditësit të i kompensoj të ardhurat personale të pa paguara – zbritura në mënyrë kundërligjore, në emër të mungesës në market për muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2016, në shumë prej 202.59 euro, si dhe në emër të diferencës së të ardhurave personale të pa paguara për muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2016 në shumë prej 60 euro e në shumë të përgjithshme prej 262.59 euro” **si e pa bazuar**.

A r s y e t i m

Paditësi A.Sh., Komuna e Gjakovës, me dt. 13.05.2016 ka parashtruar padi në gjykatë (e precizuar me parashtrësën e datës 27.06.2019), kundër të paditurës P.O.S., L.L.C., Fushë Kosovë, me të cilën ka kërkuar që të anulohen si i kundërligjshëm vendimet i të paditurës nr. Nr. 02/2016 të datës 06.04.2016, me të cilin i është ndërprerë kontrata e punës, si dhe të detyrohet e paditura që të ja kompensojë të ardhurat personale në bazë të kontratës së punës dt. 31.07.2015, si dhe ti paguajë shpenzimet procedurale.

Juridiksioni i gjykatës:

Fillimisht, gjykata shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështjeje dhe bazuar në nenin 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), por edhe me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, më saktësisht nenit 79, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykatë është kompetente për të vendosur këtë çështje.

Lidhur me kompetencën lëndore, në bazë nenin 17.2 të LPK-së: *“Vlerësimi i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura gjykata”*. Meqënëse ndodhemi përpara një kontesti me karakter civil që rrjedh nga marrëdhënia e punës, gjykata çmon se është kompetente nga pikëpamja lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje.

Lidhur me kompetencën territoriale në bazë të nenit 49 të LPK-së: *“Në qoftëse në kontestin nga marrëdhënia e punës paditës është punëtori, për gjykim është kompetente përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale për të paditurin, edhe gjykata në territorin e së cilës kryhet puna ose është kryer, respektivisht gjykata në territorin e së cilës puna është dashur të kryhet, si dhe gjykata në territorin e së cilës është themeluar marrëdhënia e punës”*. Duke qenë se në bazë të kontratës së punës së paditëses është kontraktuar që puna të kryhet në territorin e Gjakovës, rezultoi se kompetente për shqyrtimin e kësaj çështjeje civile është kjo gjykatë.

Pala paditëse, legjitimohet t’i drejtohet gjykatës me këtë padi pasi pretendon se i janë shkelur të drejtat nga marrëdhënia e punës, dhe kërkon të rivendosë në vend këto të drejta. Pala e paditur ka legjitimitet real pasiv në këtë çështje juridike pasi që ka qenë në raport kontraktual me paditësen dhe e njëjta ja ka shkëputur kontratën e punës kësaj të fundit.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të nenit 67 të LPK-së, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga palët prezent në gjykim.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe parashtrimeve të parashtruara në seancat e kaluara dhe konsideroi se në rastin konkret paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas kontratës në kohë të caktuar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Punës kontratës kolektive si dhe marrëveshjes të përgjithshme kolektive të Kosovës. Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se mbes në tërësi pranë padisë dhe kërkesë-padisë së precizuar në parashtrësën e datës 27.06.2019 dhe konsideroi se në bazë të provave të administruara është argumentuar dhe vërtetuar baza dhe lartësia e kërkesë padisë. Paditësit tek i padituri ka qenë i punësuar në kohë të caktuar duke filluar nga data 20.03.2015 deri me datë 19.06.2015 në punën dhe detyrat e punës si shitës në stacionin e benzinës numër ... në Gjakovë e cila kontratë me aneks kontratën me numër 2/2015 paditësit i është vazhduar kontrata e punës deri me 30.06.2016 të cilit me aneks kontratë i është bërë edhe rritja e pagës në 250 euro në muaj paditësi ka qenë duke shfrytëzuar pushimin vjetor sipas aktvendimit nr.3 të datës 18.01.2016 të cilin pushim paditësi e ka shfrytëzuar nga data 21.03.2016 e deri me datë 08.04.2016 të cilit me aktvendim numër 02.16 të datës 06.04.2016 i është ndërprerë marrëdhënia e punës për kinse shkelje e rëndë e detyrave e të punës i cili aktvendim është në kundërshtim me dispozitat e ligjit të punës dhe dispozitave e akteve normative të paditurit pasi që ndaj paditësit nuk është zhvilluar procedurë disiplinore për vërtetimin e përgjegjësisë së tij për kinse shkelje të rënda të detyrave të punës andaj si aktvendimi i kontestuar dhe tërë procedura e largimit nga puna e paditësit nga ana e të paditurës është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e nenit 5, nenit 7, 8, dhe 9 të rregullores për përgjegjësi disiplinore dhe largim nga puna dhe përveç shkeljeve të rregullores është vepruar dhe në kundërshtim me nenin 70 të Ligjit të Punës. Nga deklarimi i dëshmitarëve V.N., B.M. dhe dëgjimi i paditësit në cilësi të palës është vërtetuar se

paditësi në kohën kur e paditura pretendon se paditësi ka bërë shkelje të rëndë të detyrave të punës për të cilin është dyshuar se i njëjti ka huazuar para nga arkas është vërtetuar se paditësi në atë kohë nuk ka qenë në punë por që i njëjti ka qenë në shfrytëzim të pushimit vjetor. Andaj me veprime të kundërligjshëm të et paditurës paditësit i është shkaktuar dëm duke i ndalur të ardhurat personale për muajt prill, maj dhe qershor të viti 2016 aq sa kishte edhe kontratë mbi themelimin e marrëdhënies së punës andaj nga e gjithë kjo i ka propozuar gjykatës që ta aprovoi në tërësi kërkesë padinë e paditësit të precizuar me datë 27.06.2019 si dhe i ka kërkuar shpenzimet procedurale dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104 euro, për përpilimin e ankesës së datës 08.04.2018 shumë prej 104 euro për pjesëmarrje në 5 seanca gjyqësore shumë prej 135.20 euro për seancë për pjesëmarrje në seancën e datës 10.02.2018 shumë prej 67.60 euro dhe në emër të shpenzimeve për ekspertizën financiare shumë prej 120 euro e në shumë të përgjithshme prej 1071.60 euro.

I autorizuari i të paditurës, av. E.K. nga Prishtina, në shqyrtimin gjyqësorë ka deklaruar se qëndroj në tërësi pran kundërshtimeve nga seancat e kaluara, e kundërshtoj në tërësi padinë dhe kërkesë padinë e paditësit si të pa bazuar. Në fjalën përfundimtare të dhënë me shkrim të datës 02.07.2019, ka deklaruar se e kundërshtojë në tërësi padinë dhe kërkesë-padinë ve paditësit si të pa bazuar sepse nga provat që janë administruar nuk është vërtetuar themelësia e kërkesë-padisë dhe atë për arsye sepse nga e-maili i datës 22.03.2016 të cilin kryepunëtori B.M. i ka dërguar T.T., A.F., F.B.dhe P.B. që të gjithë zyrtarë të paditurës, është vërtetuar se paditësi A.Sh. ka ardh në pikën e karburantit të të paditurës që gjendet në rrugën Gj.-P. dhe nga arka e të paditurës, pa lejen e askujt i ka marrë 350 euro të cilat i ka kthyer pas disa ditësh për çka edhe paditësit me të drejtë i është ndërprerë marrëdhënia e punës sipas aktvendimit të të paditurës numër 02/2016 të datës 06.04.2016 e cila edhe ashtu i skadonte pas tre muajsh, pasi që i njëjti i kishte shkelur detyrat e tij nga marrëdhënia e punës kështu që me veprimet e cekura më lartë paditësi ka bërë shkelje të detyrave të punës sipas nenit 4 pika 12,32,38 dhe 45 të rregullores së të paditurës mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale, pasi që ka të bëjë me keqpërdorimin e detyrës zyrtare lidhur me marrjen e mjeteve financiare. Në këtë drejtim gjykatës i propozojmë që mos t'ia falë besimin dëshmitarëve B.M. dhe V.N. pasi që dëshmitë e tyre janë të ndikuara nga ana e paditësit. Sa i përket ekspertizës së ekspertit financiar, për palën e paditur nuk është relevante nga se nuk është formuar baza juridike e kërkesë padisë së palës paditëse, dhe nga ky aspekt nuk paraqet ndonjë provë me rëndësi, për të cilën edhe është nxjerrë kjo provë dhe është administruar në gjykatë. Pavarësisht të cekurave, kërkesë-padia e palës paditëse që përveç pagave të i kompensohen edhe ndalesat në shumë prej 202.59 euro, e kjo në emër të mungesës në market të llogaritura si ndalës, pasi që pala paditëse këtë kërkesë nuk e kishte parashtruar deri më tani por vetëm me datë 27.06.2019 rezulton se në pajtim me nenin 357 par.1 të LMD-së, është parashkruar dhe si e tillë së bashku me kërkesën kryesore duhet refuzuar pasi që kanë kaluar më tepër se tri vite nga dita kur për ndalesat e tilla apo për dëmin që i është shkaktuar paditësit, rezulton se kjo ka ndodhur para muajit 4 të vitit 2016 e që për një fakt të tillë paditësi e ka ditur. Faktin që e paditura i ka ofruar palës paditëse shumë prej 1000 euro në emër të marrëveshjes gjyqësore, ishte vetëm si shenjë e vullnetit të mirë të palës së paditur, duke pasur parasysh faktin se paditësi deri në ditën kur i shkeli detyrat e punës ishte punëtor i mirë dhe i suksesshëm në punë andaj dhe i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesë-padinë e paditësit ta refuzoi si të pa bazuar. I ka kërkuar shpenzimet procedurale dhe atë për përfaqësim në pesë seanca gjyqësore nga 135 euro për seancë e në shumë të përgjithshme prej 676 euro.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e plotë të gjendjes faktike dhe fakteve vendimtare, gjykata gjatë shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: është bërë leximi në kontratën e punës të datës 31.07.2015 e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës; leximi në aneks kontratën e punës të datës 09.10.2015 me numër 2/2015 e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse; aneks kontratën e punës të datës 29.12.2015 me numër 2/2015; aktvendimi me numër 2/2016 të datës 06.04.2016; kërkesa për rishikimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 28.04.2016; aktvendimin me numër 3/2016 të datës 18.01.2016; e-maili i dërguar nga B.M. për L.T. të datës

22.03.2016; ekspertiza financiare e ekspertit H.B. ecc.dipl. të datës 27.05.2019; plotësim ekspertizës së financiare e ekspertit H.B. ecc.dipl. të datës 26.06.2019 dhe dëgjimin e ekspertit në shqyrtim gjyqësor; dëgjimi i paditësit A.Sh. në cilësi të palës; dëgjimi i dëshmitarëve V.N. dhe B.M. që të dy nga Gjakova .

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është **pjesërisht e bazuar**.

Nga leximi në kontratën e punës të datës 31.07.2015 e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi A.Sh. Komuna e Gjakova me të paditurën P.O.S. L.L.C. si punëdhënëse, kanë lidhur kontratë të punës me datë 31.07.2015, për kohë të caktuar duke filluar nga data 01.08.2015 deri më 19.09.2015, në detyrat e punës si shitës në Stacionin e benzinës, gjithashtu të njëjtët janë dakorduar edhe me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që lindin nga marrëdhënia e punës.

Nga leximi në aneks kontratën e punës të datës 09.10.2015 me numër 2/2015 e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse, gjykata ka vërtetuar faktin se palët kontraktuese të kontratës së punës së datës 31.07.2015, janë dakorduar që punëtorit A.Sh. të rriten të ardhurat personale (paga bazë) në 250 euro në muaj.

Nga leximi në aneks kontratën e punës të datës 29.12.2015 me numër 2/2015, gjykata ka vërtetuar faktin se palët kontraktuese të kontratës së punës së datës 31.07.2015, të punësuarit këtu paditësit i kanë vazhduar kontrata e punës deri më 30.06.2016.

Nga leximi në aktvendimi me numër 2/2016 të datës 06.04.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se punëdhënësi këtu e paditura me datë 06.04.2016, i ka ndërprerë kontratën e punës e nënshkruar me datë 31.07.2015, për shkak të shkeljeve të rënda të detyrave të punës, rast i rëndë i sjelljes së keqe dhe mos përmbushje e detyrave të punës, i cili aktvendim ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga Drejtori ndërsa është përfundimtar ditën e dorëzimit të tijë

Nga leximi në kërkesën për rishikimin e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të datës 28.04.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi A.Sh. nga Gjakova, ju është drejtuar punëdhënësit, këtu të paditurës, për ta rishikuar aktvendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, e cila shkresë ka mundur të pranohet si ankesë kundër vendimit mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës duke e arsyetuar se vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës është i kundërligjshëm dhe ka propozuar që i njëjti të anulohet.

Nga leximi në aktvendimin me numër 3/2016 të datës 18.01.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se punëdhënësi, këtu e paditur i ka caktuar pushimin vjetorë të punësuarit A.Sh., i cili këtë pushim vjetorë e ka shfrytëzuar prej datës 31.03.2016 deri më 08.04.2016, i cili sipas këtij aktvendimi, punëtori është dashur që të lajmërohet në punë me datë 11.04.2016.

Nga leximi e-maili i dërguar nga B.M. për L.T. të datës 22.03.2016, gjykata ka konstatuar faktin se B.M. ka dërguar e-mail tek L.T., i cili e ka informuar se me datë 22.03.2016 unë B.M. me rregull të orarit kam pasur pushim, punëtori V.N. dhe L.R. që kanë qenë në ndërrim para, më kanë lajmëruar se punëtori A.Sh. ka ardhur në pompë dhe në arkë i ka marrë 350 euro, të cilit i kam thënë që duhesh me i kthyer parat dhe i njëjti më ka thënë se do ti kthej për dy ditë, gjykata kësaj prove nuk ja fali besimin pasi që e njëjta nuk ka mbështetje në provat që janë administruar në këtë çështje kontestimore.

Nga ekspertiza financiare e ekspertit H.B. ecc.dipl. të datës 27.05.2019 dhe plotësim ekspertizës së financiare e ekspertit H.B. ecc.dipl. të datës 26.06.2019, gjykata ka vërtetuar faktin

se sipas kontratës së punës të datës 31.07.2015 dhe aneks kontratës së datës 29.12.2015, paditësi deri në ditën e ndërprerjes së kontratës së punës ka realizuar të ardhura personale në shumë prej 250 euro në muaj e që në bazë të kontratës së punës së datës 31.07.2015 punëdhënësi ka mbetur pa i paguar të punësuarit këtu paditësit shumë prej 750.00 euro në për muajt prill, maj dhe Qershor të vitit 2016, sa i njëjti ka pasur edhe afat të kontratës deri më 30.06.2016, gjithashtu të njëjti i është llogaritur edhe kamata për mjetet e pa paguara dhe ajo është shuma prej 195.10 euro për periudhën kohore prej 06.04.2016 deri më 30.06.2016, gjykata pjesërisht ja fali besimin ekspertizës së datës 27.05.2019 dhe plotësisht plotësim ekspertizës së datës 26.06.2019, pasi që e njëjta është e përpiluar në mënyrë shkencore dhe se eksperti me sqarimet e tij në seancën e shqyrtimit kryesorë ka bërë sqarimin e mjaftueshëm të kësaj ekspertize dhe si e tillë është edhe e bazuar. Ndërsa sa i përket pjesës tjetër të ekspertizës në lidhje me llogaritjen e ndalesave të bëra për shpenzimet në market për muajt janar. Shkurt dhe mars si dhe diferencën e pagesës për muajt e cekur gjykata nuk ja fali besimin dhe nuk i vlerësoj për faktin se eksperti në përpilimin e ekspertizës së datës 27.05.2019 ka bërë tejkalimin e detyrave të tije pasi që gjykata nuk i ka caktuar ekspertit detyra të tilla dhe në këtë mënyrë edhe të njëjtat për gjykatën janë të pa rëndësishme, gjë që me plotësim ekspertizë eksperti ka bërë edhe rregullimin e ekspertizës në bazë të detyrave të caktuara nga gjykata.

Nga dëgjimi i paditësit A.Sh. i dëgjuar në cilësi të palës, i cili në shqyrtimin kryesorë ka deklaruar se unë tek e paditura kam filluar punën në muajin mars të viti 2015 dhe kam pasur kontratë në afat të caktuar e cila kontratë pas skadimit të afatit e njëjta është vazhduar me aneks kontratën deri në muajin qershor të vitit 2016 unë me datë 21.03.2016 kam marrë pushimin vjetor dhe që nga ajo ditë më nuk jam kthyer në punë pasi që me datë 21.03.2016 F.B. e ka thirr B.M. i cili ka qenë kryepunëtor tek e paditura e i cili ka qenë në pushim vjetor dhe e ka detyruar që ta qoi një e-mail tek e paditura kinse unë kam marrur para tek e paditura pa lejen e askujt, B. e ka dërguar këtë e-mail dhe mua më ka kontaktuar në telefon dhe më ka thënë se i ka thënë atij F. për mua se unë nuk e kam të gat në punë, pas kthimit nga pushimi vjetor unë kam punuar 15 ditë tek e paditura dhe pas 15 dite ma kanë dhënë aktvendimin që ma kanë ndërprerë marrëdhënien e punës dhe konsideroi se të njëjtët më kanë diskriminuar që më kanë larguar për hajni e që këtë unë kurrë nuk e kam bërë. L.T. i cili është menaxher i të paditurës më ka ftuar në zyrë tek B. dhe ma ka dorëzuar aktvendimin që më kanë larguar nga puna dhe më ka thënë A. mos e lë kështu por ankohu kundër këtij aktvendimi sepse të kanë nxjerrë pa të drejtë prej punës. Ai më tej ka shtuar se e kam thirrur në telefon P.P. i cili është jurist i kompanisë dhe e kam pyetur se çka është ky aktvendim dhe çka keni shkruar aty, ai më ka thënë se lisi i njomë djeget në të thatin. Ndaj meje asnjëherë nuk është iniciuar procedurë disiplinore dhe nuk më është shqiptuar asnjë masë disiplinore për shkelje të detyrave të punës. Gjykata deklarimit të paditësit ia fali besimin e plotë pasi që e njëjta ka mbështetje në provat që gjinden në lëndë dhe e njëjta është në përputhshmëri edhe me deklaratimet e dëshmitarëve.

Nga dëgjimi i dëshmitarit V.N. data e lindjes..., i cili në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se unë kamë qenë në marrëdhënie pune tek e paditura edhe pse viti i saktë nuk më kujtohet ku kamë filluar në punë dhe deri sa kam qenë duke punuar A. është larguar nga puna. Unë e di se A. ka qenë në pushim kur e kanë pruar vendimin për me e largu prej punës, aty ka ardhur B. i cili ka qenë menaxher i yni ka hyrë në zyre dhe e ka dërguar një e-mail në Prishtinë dhe përmbajtja e e-mailit ka qenë se gjëja A.Sh. ka ardhë nga pushimi në ndërrimin tim dhe ka marrë 300 euro e cila nuk është e vërtetë pasi që sikur A. të kishte ardhë dhe ti kishte marrë ato 300 euro, unë nuk kisha mundur që ti dorëzoj parat e ndërrimit apo pazarin ditor me minus 300 euro por unë e kam dorëzuar pazarin dhe kam dalur me zero mungesa edhe pse pas dy apo tri dite saktë nuk më kujtohet i ka ardhë vendimi që A. është larguar nga puna. Gjykata deklarimit të dëshmitarit ja fali besimin e plotë pasi që e njëjta ka mbështetje në provat që gjinden në shkresat e lëndës.

Nga dëgjimi i dëshmitarit B.M. nga Gjakova data e lindjes..., i cili në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se unë kam qenë krye punëtorë pran të paditurës dhe është e vërtetë që e kam dërguar unë e-mailin por arsyeja pse unë e kam dërguar është kjo: unë atë ditë kam qenë në pushim ditor,

dhe më ka thirrur në telefon F.B., më ka thënë se duhet gjithsesi të shkosh në firmë dhe të shkruash një email, edhe pse unë atë ditë kam qenë me familjen time, pra nuk kam qenë në punë, dhe përafërsisht një orë unë kam arritur në firmë dhe aty kanë qenë dy punëtor V.N. dhe L.R., V.N.e kam takuar në market, dhe e kam pyetur se çfarë problemi është, i njëjti më ka përgjigjur se nuk kemi asnjë problem. Unë më pastaj kam hyrë në zyrën time, dhe e kam shkruar emailin ashtu siç më ka thënë F., dhe pasi që punëtorët më kanë thënë se nuk ka problem unë kam hyp në veturën time dhe kam shkruar në shtëpinë time ,pasi që ajo ditë ka qenë për mua pushim. Më tej ka shtuar se F. në telefon më ka thënë se në email të shkruaj se punëtori A.Sh. i ka marr 350.00.-€, nga punëtorët që kanë qenë në atë ndërrim. Dhe unë i kam thënë se mos të ngutet sepse nesër shkoi në punë dhe e këqyrim se ku është problemi. Të nesërmen unë kam filluar punën dhe kam vazhduar me rregulloren e punës. Më tej ka shtuar se unë në email nuk kam shkruar atë çfarë kam parë por e kam shkruar atë çfarë më ka thënë F., pasi që, kolegu V.N. më ka thënë se nuk ka kurrgjë këtu dhe unë kam vazhduar punën. Gjykata dëshmisë së dëshmitarit ja fali besimin e plotë pasi që e njëjta ka mbështetje në prova që gjinden në shkresat e lëndës.

Baza Ligjore:

Neni 70 i Ligjit të Punës Nr.03/L-212, i cili ka hyrë në fuqi me **dt.16.12.2010**, përcakton rastet e ndërprerjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit, ku ndër të tjera parag.1.4.1 dhe 1.4.2 të nenit 70 thotë se punëdhënësi mund të ja ndërprej kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit a) *në rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit* dhe b) *për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës*. Ndërsa parag.1.6 i po këtij neni përcakton rastet e ndërprerjes së kontratës së punës pa paralajmërim, a) *i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një sjellje më pak serioze ose shkeljes së detyrimeve* dhe b) *performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim*. Nenet 78 dhe 79 të këtij ligji përcaktojnë afatet për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës fillimisht tek punëdhënëse, e pastaj në gjykatë. Neni 95 parag.1 i po këtij ligji të "*Punëdhënësit janë të obliguar që aktet e brendshme me të cilat rregullohen marrëdhëniet e punës, ti harmonizojnë me dispozitat e këtij ligji, jo më vonë se 6 muaj pas hyrjes në fuqi të tij*", ndërsa parag.2 i këtij neni thotë "*Deri në nxjerrjen e akteve të brendshme nga parag.1 i këtij neni, drejtpërsëdrejti aplikohen dispozitat e këtij ligji*". Neni 96 i po këtij ligji përcakton "*Deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të punësuarit i realizojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës në bazë të dispozitave që kanë qenë në fuqi*". Neni 99 i këtij ligji thotë: "*Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27 për Ligjin Themelor të punës në Kosovë, dt.08.10.2001, ligji mbi Marrëdhëniet e Punës i KSA të Kosovës i vitit 1989 dhe Ligji i Punës i Jugosllavisë i vitit 1977 me amendamente*". Neni 80 pika 1 i po këtij ligji thotë: "*Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve: 1.1. ti paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave të tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shuma të tilla që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit të tij...*

Rregullorja e brendshme e të paditurës, e cila është miratuar në 27.01.2016, përcakton kushtet dhe kriteret për themelimin e marrëdhënies së punës, ndërsa kapitulli i II rregullon sjelljet të cilat u ndalohen puninjësve të P.O. S. L.L.C dhe në rast të shkeljës së këtyre rregullave rregullon çështjen e masave disiplinore dhe ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatës:

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjendjes faktike të cilën e kemi cekur më lartë, gjykara erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar në ligj dhe fakte.

Gjykata vlerëson se e paditura me rastin e shkëputjes të kontratës së punës paditësit me aktvendimin e saj nr. 02/2016 të datës 06.04.2016, e njëjta nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të Ligjit të Punës si dhe aktin të brendshëm të sajë po ashtu edhe nuk ka vërtetuar gjendjen faktike, lidhur me shkeljet ku në aktvendim e saj mbi shkëputjen e kontratës mbi marrëdhënien e punës paditësit në këtë rast ka cekur se paditësi ka kryer “*rast i rëndë i sjelljes së keqe dhe mos përmbushje të detyrës së punës*”, sipas të paditurës janë vlerësuar si shkelje të rënda të detyrave të punës e që kanë rezultuar me shkëputjen e kontratës së punës.

Gjykata gjatë vlerësimit të fakteve të provuara ka vërtetuar se aktvendimi me të cilin i është shkëputur kontrata e punës paditësit, si në dispozitiv po ashtu edhe në arsyetim nuk ka bazë ligjore. E paditura me as një provë nuk ka mundur që të vërtetoj shkeljet të detyrave të punës nga ana e paditësit të pretenduara si në aktvendimin e lartcekur, fakti se është pretenduar se paditësi A.Sh. ka bërë shkelje të detyrave të punës duke marr para nga e paditura pa e pyetur askënd, të paditurës nuk i jep të drejt që të veproj në kundërshtim me ligjin e punës e po ashtu edhe në kundërshtim me aktet nënligjore të vet të paditurës të cilat përcaktojnë se në rast të dyshimit për shkelje të detyra të punës, ndaj të punësuarit duhet të zhvillohet procedurë disiplinore, ti vërtetoj faktet e pretenduara dhe më pastaj ti ndërpritet marrëdhënia e punës nëse në procedurë disiplinore vërtetohet se i punësuar ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës. Gjykata nga administrimi i provave në këtë çështje kontestimore nuk ka mundur ta vërteton faktin se e paditura ka vepruar sipas ligjit të punës që rregullon shkëputjen e marrëdhënies së punës përkatësisht e njëjta nuk ka zhvilluar procedurën disiplinore në të cilën procedurë do të kishte mundësi që ti paraqet edhe pretendimet e tija paditësi. Gjithashtu gjykata nga administrimi i prova ka vërtetuar faktin se i punësuar këtu paditësi nuk ka bërë shkelje të detyrave të punës pasi që me as një provë nuk ka mundur të vërtetohet se i njëjti sa ka qenë në pushimin vjetorë ka shkuar në stacionin e benzines të të paditurës në Gjakovë dhe nga arka ka marrë shumën e parave prej 300 euro pa e pyetur askënd siç pretendon e paditura, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga dëgjimi i dëshmitarëve të cilët kanë deklaruar se “*atë ditë për të cilën pretendohet për shkelje të detyrave të punës, paditësi nuk ka marrë para nga arka*”. Andaj dhe nuk mund të themi se paditësi ka bërë shkelje të detyrave të punës. Gjithashtu, gjykata nga administrimi i provave ka vërtetuar se e paditura duke mos respektuar procedurat ligjore ka shkëputur kontratën e punës duke e improvizuar kinse i punësuar A.Sh. ka marrë para nga arka pa e pyetur askënd, ashtu që përmes eprorëve të punëdhënësit F.B. është detyruar punëtori B.M. që të dërgoj e-mail kinse për të lajmëruar shkeljet e punëtorit A.Sh., gjë që vet B.M. në shqyrtim kryesorë ka deklaruar se më kanë detyruar që ta dërgoj këtë e-mail në të cilin e-mail “*kam shkruar atë që më kanë urdhëruar dhe jo atë çfarë kam parë*”, përveç tjerash ky fakt vërtetohet edhe nga dëshmia e dëshmitarit V.N. dhe paditësi A.Sh.. Andaj, nga të lartcekurat, gjykata vlerëson se vendimi për shkëputjen e kontratës së punës paditësit Nr. 02/2016 të datës 06.04.2016, është marr me shkelje të dispozitave ligjore të Rregullores së brendshme të të paditurës, të cilat i kemi cekur më lartë, si dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore të parapara me Ligjin e Punës, andaj edhe vendosi që ta anuloj aktvendimin si të paligjshëm.

Lidhur me pikën II të dispozitivit të aktgjykimi, gjykata vendosi bazuar në nenin 80 paragraf 1.1 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03/L-212), ku vendosi ta detyrojë të paditurën që në emër të kompensimit të të ardhurave personale, paditësit ti paguajë 3 (tri) paga mujore. Kjo bazuar në kontratën e punës të datës 31.07.2019 si dhe aneks kontratën me nr. 2/2015 të datës 29.12.2015, e cila ka qenë e lidhur në kohëzgjatje prej 01.08.2015 deri më dt.30.06.2016, ndërsa e njëjta është ndërprerë me dt.06.04.2016, që do të thotë se paditëses duhet ti paguhen pagat mujore në shumë prej 250 € bruto për 3 (tri) muajt e mbetur (prill- maj dhe qershor, 2016), apo gjithësejt shumë prej 750.00 € bruto. Si dhe kumatën ligjore prej 195.10 euro , gjë që është vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit financiar H. B. nga Gjakova. Gjykata vlerëson se pagesa e shumës së lartcekur paditëses është adekuate dhe e drejtë, për shkak se siç është cekur më lartë vendimi i të paditurës me të cilin i është shkëputur kontrata e punës ka qenë i paligjshëm.

Sa i përket pjesës së refuzuar në lidhje me kompensimin e të ardhurave personale të papaguara – zbritura në mënyrë kundërligjore në emër të mungesës në market në shumë prej 202.59 euro për muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2016 si dhe në emër të diferencës së të

ardhurave personale të pa paguara për muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2016 në shumë prej 60 euro. gjykata me as një provë nuk ka mundur ta vërtetonte faktin se paditësit i janë ndaluar këto të ardhura personale. Mirëpo me qenë se i autorizuari i të paditurës ka kontestuar edhe këtë pjesë së kërkesës duke u thirrur në parashkrimin e kërkesës, gjykata pas vlerësimit të të njëjtit ka konstatuar se kërkesa e paditësit në lidhje me kompensimin e të ardhurave personale të papaguara – zbritura në mënyrë kundërligjore në emër të mungesës në market në shumë prej 202.59 euro për muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2016 si dhe në emër të diferencës së të ardhurave personale të pa paguara për muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2016 në shumë prej 60 euro. është e parashkruar në kuptim të nenit 87 të ligjit të punës i cili parasheh që “ *Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”. në rastin konkret paditësi kërkesën për kompensimin e këtyre të ardhurave personale të ndaluara në mënyrë kundërligjore e ka parashtruar me datë 27.06.2019 me parashtruesin me të cilën ka bërë edhe precizimin e kërkesës padisë e që nënkupton se i njëjti këtë kërkesë e ka parashtruar pas kalimit të afatit tre (3) viteve, pasi që kërkesa ka të bëjë me muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2016, dhe kërkesa është parashtruar me datë 27.06.2019, andaj nga të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv nën **IV** të këtij aktgjykimi.

Vendimin për shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.2 të LPK-së duke pas parasysh suksesin në procedurë, gjykata vendosi që t’ia njeh këto shpenzime palës paditëse dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104 euro, në emër të ekspertizës shumë prej 100 euro, në emër të tri seancave shumen prej 135.20 euro për secilën seancë, gjithsej shumë prej 405.6 euro e në shumë të përgjithshme prej 609.60 euro.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 80 të Ligjit të Punës, lidhur me 143 të LPK-së.

GJYKATA KOMUNALE NE GJAKOVË
C.nr.721/18 dt. 22.07.2019

Zyrtare ligjore,
Merita Xharavina

Gjyqtari,
Besnik Bislimaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.